

20111342964

## L I G J

### **PËR NGARKIM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISE ME PJESËN E PARË TË HUAS TE BANKA INVESTUESE EVROPIANE SIPAS MARRËVESHJES FINANCIARE PËR PROJEKTIN PËR NDERTIM TË AUTOSTRADËS SË KORRIDORIT X, NË AKSIN RRUGOR DEMIR KAPI-SMOKVICË**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Investuese Evropiane me hua në shumë prej 65 000 000 eurosh, si kofinancim nacional i dedikuar për realizimin e Projektit për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, që pjesërisht do të financohet nepermjet Instrumentit për ndihmë paraaderuese-IPA të Bashkimit Evropian.

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje financiare për Projektin për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Investuese Evropiane.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen financiare nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave apo personi i autorizuar nga ai.

#### Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të tërhiqet në më së shumti pesë transhe.

Afati i pagesës së çdo transheje nga huaja mund të jetë prej së paku katër vjet deri në më së shumti 25 vjet nga data e tërheqjes së transhesë, me grejs periudhë të perfshire që mund të jetë ndërmjet 60 ditësh dhe shtatë vitesh nga data e tërheqjes së transhesë.

Afati i pagesës së huas do të caktohet për çdo transhe veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për terheqjen e mjeteve të huas nga Ministria e Financave.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njehershme në ditën që është ndërmjet tre dhe 16 vitesh nga dita e tërheqjes së transhesë.

#### Neni 4

Shkalla kamatare do të përcaktohet për çdo transhe të huas veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për terheqjen e mjeteve të huas nga Ministria e Financave, varesisht se cila shkallë kamatare është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variabile).

#### Neni 5

Pjesen e huas në shumë prej 63 500 000 eurosh, që do të dedikohet për financimin e Marrëveshjes për punë ndertimore dhe Marrëveshjes për mbikëqyrje të punëve ndertimore për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, do ta realizojë Struktura operative e përbërë nga Ministria e Financave-Spektori për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Agjencia e Rrugëve Shtetërore.

Pjesen e huas në shumë prej 1 500 000 eurosh, që do të dedikohet për financimin e Marrëveshjes për sigurim të ndihmës teknike për Njësinë për realizimin e Projektit për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, do ta realizojë Agjencia e Rrugëve Shtetërore.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".